


## Çfarë ndodh nëse nuk respektohen të drejtat?

Ushtrimi i të drejtave të caktuara mund të kufizohet për arsye të ndryshme, për shembull për t'ju mbrojtur kundër një dëmi domethënës ose për të pasur parasysh maturinë dhe moshën tuaj. Disa të drejta, të tilla si e drejta e jetesës, shëndetit dhe mbrojtjes kundër dhunës dhe shfrytëzimit mund të mos kufizohen kurrë, edhe nga prindërit dhe mësuesit. Nëse mendoni se u janë cenuar të drejtat ju mund:

- të flisni me persona të besuar, të tillë si prindërit, mësuesit, mjekët, shokët, punonjësit socialë ose persona që mund të kujdesen për ju;
- merrni në telefon në numrin e posaçëm për fëmijët që janë viktime dhune për të folur me një person i cili do të jenë në gjendje t'ju këshillojë;
- shkoni në polici, bëni një ankesë dhe kërkon mbrojtje nga shteti;
- kontaktoni me avokatin e fëmijëve ose me një shoqatë vullnetare që mbron të drejtat e fëmijëve;
- ose, në raste të caktuara, mund ta çoni çështjen dhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.



BUILDING A EUROPE FOR AND WITH CHILDREN



## Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1949 dhe ka tani 47 shtete anëtare. Roli i tij është të promovojë të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Ai vendos parime të përbashkëta demokratike bazuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe konventa dhe rekomandime të tjera për mbrojtjen e personave, të cilat, sigurisht, përfshijnë të 150 milionë fëmijët e Evropës.

Programi "Ndërtimi i një Evrope për dhe me Fëmijët" lidhet me nxitjen e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna. Skuadra përgjegjëse për programin trajton çështje të tilla si dhuna në familje dhe në shkollë, edukimi mbi të drejtat e njeriut, fëmijët dhe interneti dhe fëmijët dhe sistemi i drejtësisë. Ju mund të vizitoni faqen tonë të internetit për më shumë informacion për konventat tona, takimet dhe botimet dhe lojën tonë online "Wild Web Woods".

"Të ndërtojmë një Evropë për dhe me Fëmijët"  
Këshilli i Evropës  
F-67075 Strasbourg Cedex  
[www.coe.int/children](http://www.coe.int/children)  
[children@coe.int](mailto:children@coe.int)

Ky dokument është realizuar me mbështetjen bujare të Qeverisë së Finlandës.

SWE - © Council of Europe - Illustration: Eric Puybaret



## Unë kam të drejta, Ju keni të drejta Ai/ajo ka të drejta ...

Hyrje në të drejtat e fëmijëve

Të gjithë kanë të drejta. Për më tepër, si djalë ose vajzë nën moshën 18 vjeç ti ke disa të drejta të caktuara specifike. Një listë e këtyre të drejtave jepet në Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1989 për të Drejtat e Fëmijëve, se cila përmban dhe hapat që duhet të ndërmarrin qeveritë për t'ju ndihmuar ju të ushtroni këto të drejta.

## Mbijetesa, mbrojtja dhe zhvillimi juaj

- Ju keni të drejtë të siguron mbrojtjen e të gjitha vendimeve që lidhen me ju, të mos diskriminoheni, për shembull, për shkak të origjinës, opinioneve, besimeve dhe seksit tuaj.
- Ju keni të drejtë të siguron mbrojtjen e të gjitha vendimeve që lidhen me ju, të mos diskriminoheni, për shembull, për shkak të origjinës, opinioneve, besimeve dhe seksit tuaj.
- Ju keni të drejtën e plotësimit të nevojave bazë, të tilla si ushqimi, veshjet, strehimi dhe shëndeti.
- Ju gëzoni të drejtën e mbrojtjes kundër të gjitha formave të shfrytëzimit, abuzimit dhe dhunës fizike ose psikologjike, duke përfshirë atë që ndodh në familje dhe në ambientet që kujdesen për fëmijët.
- Ju keni të drejtë të përfiton arsimim të një niveli të lartë për të siguruar zhvillimin më të plotë të mundshëm të personalitetit, talenteve dhe aftësive tuaja. Arsimimi juaj duhet t'ju mësojë të respektoni të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe të përgatiteni për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e të mirëkuptuarit, paqes, tolerancës, barazisë dhe miqësisë ndërmjet të gjithë njerëzve.
- Ju keni të drejtën e marrjes së një game të madhe informacioni objektiv.
- Nëse vuani nga një paftësi mendore ose fizike, ju gëzoni të drejtën e të jetuarit me dinjitet, në mënyrë që të integroheni në shoqëri, të zhvillonin personalitetin tuaj dhe të gëzoni autonominë maksimale.
- Ju gëzoni të drejtën e pushimit, aktiviteteve dëfyese, të luani, dhe të merrni pjesë në aktivitete kreative, artistike dhe kulturore në një ambient të përshtatshëm për moshën tuaj e që respekton të drejtat tuaja.



## Identiteti, jeta private dhe familja juaj

- Ju gëzoni të drejtën të keni një emër, një nënshpëtim dhe mbrojtje të identitetit tuaj. Nëse i përkisni një pakice etnike, fetare ose gjuhësore, ju nuk mund t'ju mohohet e drejta për të zhvilluar jetën tuaj kulturore, për të praktikuar fenë tuaj apo për të përdorur gjuhën e grupit tuaj.
- Ju keni të drejtë t'ju mbrohet privatësia. Askush nuk mund të ndërhyjë në mënyrë të paligjshme në jetën tuaj private, apo në jetën e familjes tuaj. Shtëpia, korrespondenca, nderi dhe reputacioni juaj mbrohen me ligj.
- Prindërit kanë përgjegjësi të ndërsjellë për rritjen dhe edukimin tuaj. Ata kanë të drejtën dhe detyrën t'ju ofrojnë udhëzime përsa i përket mënyrës si ata duhet të ushtrorjnë të drejtat e tyre dhe të respektojnë detyrimet tuaja.
- Ju keni të drejtë të dini se kush janë prindërit tuaj, dhe të rriteni prej tyre, në përjashtim të rasteve kur kjo gjë nuk është në interesin tuaj.
- Ju keni të drejtë të dini se ku janë prindërit tuaj dhe të shkoni në një shtet tjetër për t'u bashkuar me ta. Prindërit tuaj kanë të njëjtën të drejtë karshi jush.
- Në rast ndarje, ju gëzoni të drejtën e konsultimit për të gjitha vendimet që lidhen me marrëdhëniet tuaja me prindërit. Nëse jeni ndarë nga prindërit tuaj, ose prej njërit prej tyre, ju gëzoni të drejtën e të takuarit të tyre në mënyrë të rregullt, në përjashtim të rasteve kur kjo gjë nuk është në interesin tuaj.
- Adoptimi mund të autorizohet vetëm nëse ai është në interesin tuaj.



## Liritë tuaja

- Liria e mendimit: sapo të jeni në gjendje të keni një mendim, ju keni të drejtë të jepni mendimin tuaj për çdo gjë që lidhet me ju. Mendimi juaj duhet të merret parasysh.
- Liria e shprehjes: ju gëzoni të drejtën të shprehni lirisht dhe të kërkoni, merrni dhe shpërndani informacion.
- Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.
- Liria e shoqërim: ju keni të drejtë të shoqëroheni me persona të tjerë dhe të merrni pjesë në takime.

Ka kufinj në liritë tuaja. Ju duhet të respektoni të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe nuk duhet të shkaktoni kërcënim për shoqërinë ose veten tuaj.

## Ju dhe shteti

- Shteti duhet të bëjë gjithçka është e nevojshme për t'ju bërë të mundur të ushtroni të drejtat dhe liritë tuaja.
- Shteti duhet t'ju mbrojë dhe duhet të sigurojë mirëqenien tuaj. Ai duhet të ndihmojë prindërit dhe personat që kujdesen për ju duke krijuar institucione dhe shërbime për t'u kujdesur për interesat dhe mirëqenien tuaj.
- Nëse nuk mund të jetoni me familjen tuaj, shteti duhet t'ju mbrojë dhe t'ju ndihmojë. Ai duhet të gjejë një zgjidhje që merr parasysh të shkuarën tuaj si dhe kulturën tuaj; ju keni të drejtë që situata të rishikohet në mënyrë të vazhdueshme.
- Shteti duhet të ndërmarrë masa për t'ju mbrojtur nga rreziqet që lidhen me drogat e paligjshme.
- Nëse keni vuajtur nga dhuna, shteti duhet t'ju ndihmojë edukimi mbi të drejtat e njeriut në një jetesë normale.
- Ju keni të drejtë të gëzoni drejtësinë. Shteti duhet të sigurojë që sistemi i drejtësisë t'ju përgjigjet të drejtave dhe nevojave tuaja specifike.
- Ju nuk mund të ekzekutoheni ose të burgoseni me dënim të përjetshëm.
- Ju nuk mund të arrestoheni në mënyrë të paligjshme. Ndalimi duhet të jetë opsioni i fundit i mundshëm. Ai duhet të jetë sa më i shkrutër të jetë e mundur dhe duhet të marrë parasysh nevojat dhe moshën tuaj. Gjatë ndalimit, ju duhet të ndaheni nga të ndaluarit e rritur ose nga të burgosurit, dhe gëzoni të drejtën e mbetjes në kontakt me familjen tuaj, në përjashtim të rrethanave përjashtimore dhe kur e kundërta është në interesin tuaj.
- Në kohë lufte, shteti duhet t'ju mbrojë e të kujdeset për ju. Nëse jeni nën 15 vjeç, nuk mund të rekrutoheni në asnjë lloj forcash të armatosura.

Konventat ndërkombëtare janë kontrata ndërmjet shteteve. Këto kontrata duhet të parashikojnë rregulla që duhet të respektohen, por ato inkurajojnë edhe shtetet të marrin masa që janë më të favorshme për fëmijët. Nëse ligji i shtetit tuaj është më i favorshëm për ju se një konventë, atëherë duhet të zbatohet legjislativi i brendshëm i vendit tuaj.

## Organizatat ndërkombëtare dhe ju

Shtetet kanë krijuar organizata të shumta ndërkombëtare. Disa, të tilla si Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Evropës, janë krijuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, për të parandaluar konfliktet dhe për të zhvilluar shoqëri më të drejta më të zhvilluara e më demokratike. Thuajse të gjitha konventat ndërkombëtare prodhohen nga këto organizata, të cilat më pas marrin masa për të siguruar që shtetet respektojnë të drejtat e parashikuara prej tyre.

Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve monitoron zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Ju mund të konsultoheni me rekomandimet e komitetit në lidhje me vendin tuaj.

Fëmijët mund të dërgojnë çështje edhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Për shembull, Gjykata ka dënuar një shtet për mos mbrojtjen e fëmijëve kundër dënimit trupor në burg, shkollë dhe në shtëpi. Një tjetër shtet u dënua për moskujdesjen për një vajzë që po udhëtonte vetëm.

